



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skopština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17.10.2018, me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimi shqyrtim më lejoni të përshëndes, Nënkyetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë mbledhje të KPF-së, monitoruesit e OSBE-së, gazetarët, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum përmbytjen e mbledhje ka, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

R E N D D I T E

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i raportit finansiar i realizimit të buxhetit komunal për periudhën janar – shtator 2018,
3. Shqyrtimi i Draft - rregullores për Shërbime Publike,
4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit që të i jepet pëlgimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe,
5. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P- 71510031-00290-0, në fshatin Zatriq,
6. Informatë e tretë mbi securinë e hartimit të PZHK-së,
7. Të ndryshme.

Kryesuesi – Të nderuar para se ta qes rendin e ditës në votim, na ka ardhur edhe një propozim për një pikë shtesë, kjo pikë ka të bëjë me ridestinimin e mjeteve për vitin 2018. E qes në votim pikën shtesë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika shtesë. Tani të nderuar e qes në votim rendin e ditës së bashku me pikën shtesë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar

A ka dikush të shtojë diçka rrëth procesverbalit? Nëse jo e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i raportit finansiar i realizimit të buxhetit komunal për periudhën janar – shtator 2018.

Afrim Limani - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtori Limani prezantoi Raportin Finansiar janar – shtator 2018, para anëtarëve të KPF-së, ku ceku se ky raporte përbëhet nga dy pjesë, pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit. Drejtori Limani ceku të hyrat e realizuara sipas muajve ku për periudhën 9 mujore realizimi i të hyrave ishte 683,750,00 €, ku ka një ndryshim pozitiv me vitin e kaluar. Drejtori limani ceku realizimin e të hyrave sipas gjobave të gjykatave dhe trafikut, ku në periudhën 9 mujore realizimi i gjobave në trafik është 94,000.00 €, po ashtu edhe këtu kemi një ndryshim pozitiv në krahasim me vitin e kaluar, kurse realizimi i gjoba nga gjykatat këtë 9 mujor janë 15,639.00 €, por duke e ditur se rapporti 3 mujor nga gjykatat nuk është i përfshirë në këtë raport. Kurse shpenzimi i buxhetit për këtë 9 mujor të vitit 2018

është në masën prej 8,740,882.00 €, që në përqindje i bie 63.81 % buxheti i shpenzuar për këto 9 muaj. Po ashtu drejtori Limani prezantoi se në fund të rapporti e ka bashkangjitur edhe një raporte nga zyra e prokurimit, ku janë të cekura të gjitha aktivitetet në kuadër të zyrës së prokurimit.

Florije Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e kam lexuar me vëmendje këtë raport financiar sepse është në interes të gjithë ne, përfundimisht kjo praktikë është duke u praktikuar edhe tanë por edhe në të kaluarën është praktikuar, sepse së pari rapporti financiar shkon në ministri dhe pastaj vjen në kuvend, përfundimisht as atëherë nuk jam pajtuar por as tash nuk pajtohem, por kjo është e rregulluar me ligj dhe drejtoi i financave është i obliguar që të zbatoj ligjin. Tek gjobat e gjykatave është dashur të cekni që këto të hyra janë vetëm për 6 mujorin e parë, sepse shumica e këshilltarëve janë përfunduar të parë kuvendarë dhe nuk e kuptojnë, prandaj është mirë të shtohet një sqarim përmblidhje të kuvendit. Pastaj tek mbajtja e mësimit joformal sa i përket participimit, i nderuar drejtor më duket se Rregullorja përfundimisht taksa, tarifa dhe gjoba duhet këtë vit të vije në kuvend përfunduar tu miratuar dhe kishte me qenë mirë që të parashihet kjo taksë sepse mësimi jo formal nuk mundet të mbahet, sepse ata arsyetohet se nuk kemi si ti paguajmë, ne duhet që ta caktojmë një shumë se sa duhet të jetë përmësim jo formal. Sa i përket objekteve me qira, mendoj se vitin e kaluar ka pasur të hyra më të shumë përfundimisht arsyet e faljes së borxheve, atyre që ju kemi falur borxhet kanë pasur një afat përfunduar borxhin e mbetur, kishte me qenë mirë që të na sillet neve një raport ku do të shihet se sa i kanë paguar borxhet e mbetur, nëse nuk e kanë paguar atëherë i kthehet borxhi i vjetër. Tek çështjet gjinore pagat dhe mëditjet janë të cekur mbi 3,000.00 € dhe përfundimisht shërbime janë paguar 615.00 €, përfundimisht nuk e di nëse është marrë ndonjë aktivitet përfundimisht barazi gjinore, nëse po kishte me qenë mirë të na tregoni, po ashtu propozoj që të i caktohet grupit jo formal të grave një shumë 20-30 € derivate mujore përfundimisht nevojat e tyre. Tek shpenzimet e udhëtimit brenda vendit pak janë rritura, arsyen pak e di, por ajo që më ka rënë në sy është tek nënshkrimi i këtyre kontratave, kontrata bartja e nxënësve në relacionin Retij e Poshtme – Piran dhe anasjellatas, këtu nuk e kam të qartë a janë duke shkuar nxënësit tanë në Piran. Pastaj nxënësve të fshatit Zatriq a ju paguhet udhëtimi nxënësve të shkollave të mesme, nuk jam kundër kësaj pagese nëse kisha mundur do ja paguaja të gjithë nxënësve, por nëse i paguhet rregullisht nxënësve të shkollës së mesme të cilët vinë nga Zatriqi, atëherë kishte me qenë mirë që të shihet mundësia që ti paguhet 25% edhe nxënësve të tjera nga vendbanimet e tjera të cilët udhëtojnë përfundimisht shkolla të mesme.

Fehmi Cena – Përshëndetje përfundimisht, mendoj se është një raport financiar gjithëpërfshirës, po ashtu i prezantuar mjaftë qartë në mënyrë tabelare. U përmendën shifrat se sa janë të hyrat dhe sa janë shpenzimet, drejtori e ceku planin vjetor të të hyrave dhe të realizuara, ku në përqindje i bie rrëth 41,44 %, në krahasim me vitin 2017 ka rritje. Sa i përket të hyrave nga gjobat na dele që gjobat në trafik janë diku rrëth 94,000.00 €, kurse gjobat e gjykatave në krahasim me atë që është planifikuar është shumë e vogël, nuk e di kjo a është duke e paraqitur gjendjen reale apo ne si këshilltar dhe qytetarët duhet të dyshojmë në punën e gjykatave se sa janë ata racionali në zgjidhjen e lëndëve, me këtë jemi duke parë që policia e Kosovës është më e suksesshme se sa gjykatat. Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve tek shëndetësia kodi 50409 – Planifikimi, disa herë kemi pasur vërejtje rrëth këtij kodi, sepse nëse e krahasojmë realizimi e të hyrave me planifikim është tepër i vogël. Pastaj ajo që më ka rënë në sy është paraqitja në grafik, është një diskrepancë dhe na dele që kemi një ngritje dy herë ma shumë në vitin 2018 në raport me 2017, kishte me qenë mirë që kjo të përmirësohet. Tek shpenzimet sipas programeve, kishte me qenë mirë nëse do të kishim një shtyllë ku do të paraqitet planifikimi i shpenzimeve dhe pastaj realizimi, në atë mënyrë ne do të kemi më të qartë se sa është planifikuar dhe sa janë shpenzuar. Kategoria e mallrave dhe shërbimeve tek shpenzimet, ajo që të bie në sy janë shpenzimet tek zyra e kryetarit, janë disa shpenzime të cilat në raport me vitin 2017 janë goxha më të mëdha, përfundimisht periudhë janë diku rrëth 32,000.00 € më shumë në këtë vit. Mendoj se duhet që të keni kujdes në këto shpenzime, sepse nëse zyra e kryetarit përfundimisht përfundimisht 15,000.00 €, pse tanë duhet që të jetë dyfishi i kësaj shume, përfundimisht duhet të keni një arsyetim. Ne jemi që të hyrat të janë sa më të mëdha kurse shpenzimet të janë sa më të vogla, kjo do të paraqet efikasitetin e punës së qeverisë lokale. Përfundimisht do të diskutoj më gjëresisht në mbledhje të kuvendit.

Kryesuesi – E qes në votim reportin financiar të realizimit të buxhetit komunal përfundimisht janar – shtator 2018: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e parë (1) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Draft - rregullores për Shërbime Publike.

Përparim Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar draft Rregullorja për Shërbime Publike ka kaluar në disa etapa, ka qenë në dëgjim publik për 15 ditë, ku ka qenë në veb faqe të komunës dhe mjetet e tjera informuese, po ashtu me 18 shtator ka qenë debati me qytetar sa i përket kësaj rregullore, tani rregullorja është në fazën finale ku e pretë dritën jeshile nga ana e juaj. Pres nga ju ndonjë sugjerim ose propozim, të ju them të drejtën gjatë kohës sa ka qenë në dëgjim publik nuk kemi pasur ndonjë propozim ose ndonjë koment, ne grupet punuese së bashku me Drejtorin Inspektuese kemi punuar 10 ditë reshtë me dy drejtori përkatëse, ku besoj se kjo rregullore është e kompletuar.

Fahrije Lushi Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mendoj se kjo draft rregullore i përmban të gjitha elementet që të kalojë në dëgjime publike, po ashtu edhe nga ne si kuvendarë që të merë dritën jeshile ashtu siç e kërkoi edhe drejtori. Ato që duhet të diskutohen sot rreth kësaj rregullore është se në çfarë periudhe do të munden të realizohen këto që janë të cekura në rregullore, a ka ndonjë afat të caktuar, pastaj cilat pika ose pjesë i ka dhënë më shumë prioritet drejtori që të përmbyllen në një afat më të shkurtër, duke pas parasysh që është përmendur furnizimi me ujë të pijes, pastrimi i ujërave të zeza, rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve publike, ndriçimi publik etj.

Florije Boshnjaku – Kjo rregullore është e qëlluar, i ka kryer të gjitha procedurat ligjore ashtu siç e tha edhe drejtori, por për fat të keq si ministria ashtu edhe qytetarët nuk janë të gatshëm të jepin kontributin e tyre në disa çështje që janë shumë me rëndësi për ta, ndërsa kur gjobiten atëherë i bie ne mend dhe kanë ankesa pse janë gjobitur dhe arsyetohen që nuk kanë qenë të njoftuar. Sa i përket kësaj rregullore e kam shfletuar mirë sepse jam edhe juriste, në lidhje me këtë e kam shfletuar edhe ligjin për kundërvajtje, ku i kamë parë disa çështje që për kuvend kishte me qenë mirë që të përmirësohen, sepse ka disa gjëra në këtë rregullore që nuk janë në përputhje me ligjin për kundërvajtje, këtu duhet të cekni në mënyrë detale se cili është dënim i dha sa është maksimumi dhe sa minimumi. Po ashtu kam një propozim edhe pres mbështetje nga kolegët e mijë nga KPF, që ta funksionalizojmë Komitetin për Shërbime Publike, sepse kjo rregullore është dashur së pari të shkojë përmes këtij komiteti dhe ata me dhënë një pjesë të kontributit që është shumë me rëndësi. Kurse sa i përket dënimive ose sanksioneve kundërvajtësve që janë me gjoba në bazë të ligjit që është në fuqi 05 L/2016, nuk janë duke u përputhur, prandaj është mirë i nderuar drejtor që për mbledhje të kuvendit të i përmirësoni. Tek neni 43 i kësaj rregullore ceket: Marrja e pëlqimi, pastaj në fund ceket organi kompetent komunal, kishte me qenë më mirë të caktohet se te cili organ kompetent komunal duhet të marrin pëlqimin. Neni 127 paragrafi 2 Ceket: Ndalohet pastrimi i rrugëve nga ora 07:00 – 23:00, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme, larja e rrugëve mundet të bëhet nga ora 24:00 – 05:00. I nderuar drejtor këtu po mbetet një hapësirë dhe në atë kohë e kanë të drejtë apo nuk kanë të drejtë.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, e falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë rregullore, ajo që desha unë të diskutoj është rreth ndriçimit publik, ceket në këtë rregullore se do të bëhet zgjerimi i ndriçimit publik, pyetja ime për drejtorin është: A ka ndonjë plan konkret se në cilat vende do të bëhet ndriçimi publik.

Përparim Krasniqi – E nderuara znj. Fahrije Lushi Morina, rregullorja nuk e obligon drejtorinë përkatëse për realizimin e projekteve, rregullorja i cekë detyrat dhe përgjegjësit që i ka komuna në bazë të një rregullore, dhe pastaj në bazë asaj duhet të veproj ekzekutivi. E nderuara znj. Florije Boshnjaku pyeti për ligjin për kundërvajtje, e nderuar sa e di unë këtë rregullore ne jemi detyruar ta ndryshojmë për arsyet e këtij ligji, për shkak të gjobave mandatorë, ky ka qenë edhe rekomandim i zyrës ligjore, por nuk ka kurrrfarë problemi unë do e diskutoj propozimin e juaj me zyrën ligjore dhje do të shikojmë se a janë në përputhje me ligjin këto ndryshime. Neni 43 tek marrja e pëlqimit, e nderuar ka raste specifike ku pëlqimi duhet të mirët nga dy ose më shumë drejtori, kjo është arsyaja pse ne nuk i kemi specifikuar drejtoritë përkatëse. Kurse sa i përket nenit 128 paragrafi 2, aty ku ceket nga ora 07:00 – 23:00, arsyeta është se në këtë kohë është qarkullimi më i madh i automjeteve dhe komunikacioni është shumë i dendur dhe nuk lejohet me rregullore, ne këtë rregullore e kemi marrë edhe nga komunitat tjetra si model, kurse periudha më e lehtë dhe që nuk ka qarkullim të komunikacionit është nga ora 12:00 – 05:00 të mëngjesit. E nderuara znj. Florida Bajraktari ne e kemi shumë lehtë të ndërtojmë ndriçimin publik, por ne e nderuar varemi shumë nga Mallrat dhe Shërbimet, pra problemi është se kush e merë përsipër mirëmbajtjen dhe kush pagesën, para janë kufizimet buxhetore edhe nëse dëshirojmë ne ato nuk na lejojnë. Ne çdo vite duhet që të kërkojmë mallra dhe shërbime që të ritën në mënyrë që të kemi

hapësirë që të ndërtojmë më shumë ndriçime publike. Kjo rregullore tregon se çdo vendbanim duhet të ketë qasje në ndriçim publik, tregon detyrën dhe përgjegjësit që duhet të i kenë institucionet publike etj.

Fehmi Cena – I nderuar drejtore kur ka ardhur për herë të parë në kuvend kjo rregullore, dikush nga kuvendarët e ka cekur edhe një element sa i përket nivelit të zërit (zhurmës), kurse në këtë rregullore nuk jemi duke parë që është përfshirë. Janë të përfshirë që punimet nuk duhet të bëhen gjatë vikendit ku e keni cekur edhe orën, por niveli i zhurmës së muzikës që bëhen nëpër ahengje nuk është e përfshirë në këtë rregullore, mendoj se kishte me qenë mirë që të përfshihet në këtë rregullore.

Përparim Krasniqi – I nderuar ne rreth këtij problemi kemi diskutuar me zyrën ligjore, por sipas tyre sa i përket këtij problemi duhet që të bëhet një rregullore e veçantë, kurse çështja e zërit nuk mundet të përfshihet në këtë rregullore. Kjo është arsyaja pse ne nuk e kemi përfshirë në këtë rregullore propozimin e z. Minub Durguti, por do shikojmë ne mundemi të bëjmë një rregullore të veçantë ose të marrim ndonjë vendim nga kuvendi sa i përket lejimit të zërit.

Kryesuesi – E qes në votim Draft - Rregulloren për Shërbime Publike: Konstatoj se në mënyrë unanimë është aprovuar pika e tretë (3), e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit që të i jepet pëlqimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar në mungesë të drejtorit për Gjeodezi, kadastër dhe pronë po e prezantoi këtë pikë të rendit të ditës. Këtu kemi të bëjmë me një propozim për dhënie të pëlqimit në mënyrë që të iniciohen procedurat për shpronësimin e pronës së paluajtshme private, për ndërtimin, restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushe të Madhe. Me 30 qershor 2017 është marr një vendim në kuvend për shpallje të interesit të përgjithshëm të kësaj prone, ku ju është bashkangjitur edhe kërkesa e këshillit të fshatit, ku janë të cekura edhe arsyetimet pse duhet të ndodhë shpallja e interesit të përgjithshëm ose më konkretisht ky shpronësim. Në këtë rast pasi ne e kemi tanë vendimin për shpallje të interesit të përgjithshëm, po ashtu edhe kërkësën e këshillit të fshatit, tanë në këtë moment kërkohet vetëm pëlqimi i kuvendit, në këtë rast i KPF-së, në mënyrë që ne të i vazhdojmë procedurat në ministritë përkatëse dhe të kërkojmë nga ta që të bëhet ky shpronësim, njëjtë sikurse që ka ndodhur shpronësimi për shtëpinë muze të Ukshin Hotit. Kjo e gjitha bëhet që mos të shpenzohen mjetet e komunës sonë, por të mbulohet nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në rast se ata nuk përgjigjen pozitivisht, atëherë ne si komunë do të jemi të detyruar që të bëjmë këtë shpronësim në vlerë monetare pronarit që është në bazë të fletës poseduese.

Florida Bajraktari – Ne si PDK jemi pro këtij propozimi të kryetarit të komunës, që të bëhet shpronësimi i kësaj prone të paluajtshme private, është interes i përgjithshëm ndërtimi dhe restaurimi i shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe.

Florije Boshnjaku – Kemi qenë kuvendarë disa prej nesh edhe në mandatin e kaluar kur është mare ky vendim, por unë e kam një pyetje për nënënkryetarin e komunës, tek neni 3 i vendimit të viti 2017 ceket: Para shpalljes publike të vendimit për shpronësimin e pronës së paluajtshme private komuna do të paraqes kërkësë për vlerësimin të pronave të paluajtshme sipas nenit 2 të këtij vendimi, pra zyrës për vlerësim të pronës së paluajtshme. Pyetja ime është: A është paraqitur kjo kërkësë pranë kësaj zyre në vitin 2017, a keni ndonjë informatë, dhe nëse është dërguar kjo kërkësë a ka qenë komisioni nga ministria për vlerësim të kësaj prone dhe nëse po atëherë sa është shuma e kompensimit të kësaj prone.

Fehmi Cena – Pajtohem i me parafolësit edhe ne mendojmë se ky propozim është një iniciativë e qëlluar dhe është në interes të qytetarëve, komuna jonë bënë pjesë në mesin e komunave që është dëmtuar shumë gjatë kohës së luftës ku janë bërë shumë masakra. Kam një propozim sa i përket këtij propozimi, në propozim shkruan Ndërtimi i shtëpisë së masakrës, propozimi imë është që të quhet Shtëpia Muze e Masakrës së Krushës së Madhe sepse kjo e ka kuptimin e vetë si muze. Kjo është një pjesë e historisë së hidhet, po ashtu edhe e sakrificës së popullit tonë për liri.

Nënënkryetari – E nderuar znj. Florije nga marrja e vendimit me datë 30 qershor 2017 e deri më tanë nuk është ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me këtë shtëpi, prandaj tanë kemi rastin që të kërkojmë këtë vlerësim preliminar nga ministria përkatëse. Kurse sa i përket propozimit të z. Fehmi Cena, i nderuar ne kemi shkuar ashtu siç është trajtuar deri më tanë emërtimi për shpallje të interesit të përgjithshëm, por besoj se kjo nuk

është ndonjë problem mundemi të diskutojmë në mbledhje të kuvendit dhe nëse janë të pajtimit mundemi edhe të ndryshojmë emërtimin.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e Kryetarit që të i jepet pëlgimi për iniciimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme private për ndërtimin – restaurimin e shtëpisë së masakrës në Krushë të Madhe: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P-71510031-00290-0, në fshatin Zatriq.

Nënkyetari – Këtu kemi të bëjmë me një pikë të rendit të ditës për shpallje të interesit të përgjithshëm, jemi në vazhdën e shpalljeve të interesit të përgjithshëm kryesisht të parcelave ku gjenden lapidaret dhe varrezat e dëshmorëve. Qëllimi i krejt kësaj është që të ruhen dhe mirëmbahen venderrënjet e dëshmorëve dhe martirëve të kombit, ne do të kemi pikat e ngashme të rendit të ditës edhe në seancat e ardhshme. Pronar i kësaj parcele është komuna, kurse shfrytëzues është ekonomia e pyjeve, ne kur të tubojmë të gjitha këto do i drejtohem edhe agjensionit të pyjeve të Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, në mënyrë që këto prona të kthehen në emër të komunës.

Kryesuesi – E qes në votim propozimin e Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës P- 71510031-00290-0, në fshatin Zatriq: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Informatë e tretë mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së.

Rumir Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, po ju paraqes informatën e tretë mbi ecurinë e hartimit të PZHK-së. Në bazë të programit për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit, pas hartimit të Profilit Komunal, Analizës së gjendjes ekzistuese, Vizionit të Zhvillimit Hapësinor, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka vazhduar me hartimin e 3 Skenarëve të Zhvillimit Hapësinor. Nga Skenarët e Zhvillimit Hapësinor është bërë edhe propozimi për ndarjen dhe grupimin e vendbanimeve të komunës së Rahovecit në një Qendër kryesore urbane (Rahoveci) dhe në gjashtë subqendra (Krusha e Madhe, Opterusha, Ratkoci, Drenoci, Xërcë dhe Çifllaku). Është me rëndësi të potencohej se pas dhjetëra takimeve konsultative që Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Rahovecit bashkërisht me kompaninë konsulente për hartimin e PZHK-së ka zhvilluar me drejtoritë komunale dhe me Kryetarin e Komunës së Rahovecit, kanë filluar edhe takimet publike me qytetarët në qytetin e Rahovecit. Ndërsa, në ditët në vijim do të zhvillohen takime edhe me qytetarë edhe në gjashtë subqendrat e komunës së Rahovecit. Gjatë kësaj periudhe, është bërë edhe hartimi i draftit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të PZHK-së deri tek pjesa e hartimit të Skenarëve të Zhvillimit Hapësinor. Drafti i VSM-së përvëç që është diskutuar në Drejtorinë e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe në drejtoritë tjera komunale, është prezantuar edhe në takimin e mbajtur me qytetarët në qytetin e Rahovecit. Po ashtu, ky draft i VSM-së do të prezantohet edhe në takimet tjera me qytetarë edhe në gjashtë sub qendrat e komunës së Rahovecit. Pas zhvillimit të këtyre takimeve, të gjitha propozimet e qytetarëve do të trajtohen dhe do të analizohet mundësia e përfshirjes së tyre në kuadër të PZHK-së dhe VSM-së së PZHK-së, përkatësisht në kuadër të Planit të Veprimit (projekteve konkrete që do përfshihen në kuadër të PZHK-së). Dhe, pas definimit të skenarit të zhvillimit hapësinor, do të vazhdohet me zhvillimin e këtij skenari, nga i cili do të dalë edhe Plani i Veprimit dhe Dispozitat për Zbatim. Pas takimeve dhe harmonizimit të PZHK-së me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal i Rahovecit pas vendimit që do të marrë Kuvendi Komunal i Rahovecit, do të dalë në shqyrtim publik. Pas shqyrtimit publik dhe përfshirjes së kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, dhe pas miratimit të MMPH-së, Plani Zhvillimor i Komunës së Rahovecit do të miratohet nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

Fehmi Cena – Desha të ndërlidhem me diskutimin e drejtorit dhe me këtë material që e kemi afër vete, jam duke parë një dallim, drejtori e ceku këtë organizimin grupimin e vendbanimeve ku i quajti sub qendra, në më herët i kemi quajtur si bashkësi lokale, pyetja ime është: Si do të quhet tani kjo në planin e ri të PZHK-së.

Florije Boshnjaku – Në lidhje me PZHK-në ne që kemi qenë edhe më herët anëtar të kuvendit shpresojmë se ky plan të jetë më i përmirësuar dhe i hartuar në mënyrë më profesionale se ai i vjetri. Pasi që kam punuar aty po i përgjigjem në pyetjen që e parashtro z. Fehmi Cena. I nderuar Bashkësitë lokale me ligjin për vetëqeverisje lokale në Kosovë nuk ka bashkësi lokale, ne e kemi sistemin një shkallësh, prandaj pasi nuk

kemi bashkësi lokale këto janë duke u quajtur sub qendra. Sub qendra është decentralizimi i kompetencave në qendrat më të mëdha.

Rumir Zhuniqi – I nderuari z. Fehmi Cena, punën ne jemi duke e vazhduar në bazë të ligjit për Planifikim Hapësinor, sub qendrat janë njëjtë sikurse bashkësítë lokale por kështu quhen si emërtim. Çka konsiderohet sub qendër, me këtë decentralizohen kompetencat e qendrës urbane, pra shkarkohet qyteti dhe nuk do të fokusohemi vetëm në një zhvillim urban, pra është e kundërtë e zhvillimit monocentrik ku komuna ka vetëm një qendër urbane dhe fshatrat të gjitha gravitojnë vetëm me një qendër urbane, kurse policentrik sub qendrat duhet të kenë stacionet e policisë, AMF-të, shkollat ku do të gravitojnë fshatrat përreth tyre etj. që të jetë një sub qendër sipas ligjit ajo bashkësi lokale duhet që ti ketë 5000 banorë.

Fehmi Cena – Duhet të kemi kujdes në këto emërtime sepse fjala sub nuk është fjalë shqipe, mos të kemi vërejtje më vonë, ne gjithmonë jemi që ligjet evropiane të merren si model, por është mirë që ti shikoni pak terminët dhe mos të jenë gjysmë fjalë shqipe dhe gjysmë fjalë anglishtë, jam pro asaj që të gjendet një term shqip adekuat.

Florije Boshnjaku – Plotësiktë pajtohem me z. Cena kur e thotë se duhet të kemi fjalë shqipe dhe rregullisht është duke paraqitur shqetësimin rreth toponimeve të parcelave. Por ajo që është më kryesorja askund më nuk shkruan pronar por shkruan në posedim, më parë ka qenë kush është pronar dhe kush është poseduesi, pra kjo është kështu dhe ne vetëm duhet që ti zbatojmë.

Kryesuesi – Faleminderit për diskutimin e zhvilluar, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

7. Të ndryshme.

Kryesuesi – Nëse nuk ka askush të diskutoj diçka sa i përket pikës së fundit, mua më mbetet të ju falënderoj për kontributin e dhënë sot, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:20

Procesmbajtësi,

Skender Hamza



K R Y E S U E S I

Afrim Dina